



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:242914

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05486561

CP.nr.246/2010

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithëshëm, si përbarimore, gjyqtari Hajrullah Aruqi me bashkëpunëtorin profesional Agron Geci, në çështjen juridike të kreditorit I.D., nga fshati..., komuna Skenderaj, kundër debitorit R.B., nga fshati..., komuna Skenderaj, për borxh në shumën prej 250 euro, jashtë seance gjyqësore, me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET I TËRHEQUR propozimi për përbarim i kreditorit I.D., nga fshati..., komuna Skenderaj, kundër debitorit R.B., nga fshati..., komuna Skenderaj, për borxh në shumën prej 250 euro.

A r s y e t i m

Kreditori, I.D., nga fshati..., komuna Skenderaj, me dt.21.08.2010 ka ushtruar propozim për përbarim, kundër debitorit R.B., nga fshati..., komuna Skenderaj, në të cilin ka kërkuar që të lejohet përbarimi bazuar në Akvendimin – Pajtimin Gjyqësor të kësaj gjykate C.nr.12/2010 të dt.18.05.2010, ashtuqë të detyrohet debitori që në emër të borxhit t'i paguaj kreditorit shumën prej 250 euro, si dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përbarimore.

Gjykata me Aktvendimin E.nr.246/10 të dt.01.09.2010 ka lejuar përbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Gjykata pas shiqimit të shkresave të lëndës, pasi që konstatoj se propozimi për përbarim nuk i përmbante të gjitha të dhënat siç kërkohet në dispozitat e nenit 38 par.1 të LPP-së në të cilin është përcaktuar se “Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përbarimi, kërkuesi i përbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit –

vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit”, atëherë më qëllim që të vazhdohet më tutje me procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike me Konkluzionin E.nr.246/10 të dt.20.11.2023 e ka obliguar kreditorin që në afat prej tri (3) dite pas pranimit të këtij konkluzioni t’ia sjell të dhënat e sakta personale për debitorin dhe numrin personal, duke e informuar edhe me pasojat nëse nuk vepron konform këtij konkluzioni.

Në bazë të shkresave në lëndë, respektivisht fletkthesës konstatohet se kreditori e ka pranuar konkluzionin me dt.24.11.2023 duke mos vepruar sipas konkluzionit.

Bazuar në dispozitat e nenit 38 par.2 të LPP-së ku është përcaktuar se “Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”, andaj gjykata në rastin konkret veproj sipas dispozitave të nenit 102 par.3 të LPK-së ku shprehimisht thuhet “Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë”.

Andaj nga të lartcekurat gjykata konform nenit 17 të LPP-së dhe 102.3 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Departamenti i Përgjithshëm
CP.nr.246/2010, datë 21.03.2024

Gj y q t a r i,
Hajrullah Aruqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar e drejta në ankesë në bazë të nenit 261.4 të LPK-së.